VENDIM
Nr.42, datë 25.5.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË PROKURIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 "Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së", (aneksi 11), ligjit nr.10126, datë 11.5.2009 "Për miratimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a.", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 25.5.2009, duke konstatuar se procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. janë pjesë përbërëse e ligjit nr.10126, datë 11.5.2009,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a., sipas procedurave që përmban aneksi 3 i marrëveshjes për mbështetjen qeveritare, që është pjesë e aneksit 1 të Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a., miratuar me ligjin nr.10126, datë 11.5.2009.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta